

Co-funded  
by the European Union



COUNCIL OF EUROPE



Co-funded and implemented  
by the Council of Europe

## Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

# Portali Elektronik i Raportimit Financiar



## Manual Teknik i Përdorimit Monitorues



## Tabela e përmbajtjes

---

1. Hyrje.....	5
1.1 Qëllimi i manualit.....	6
2. Ndërfaqja e identifikimit të përdoruesit në sistem .....	7
3. Menuja kryesore.....	16
4. Menu: Profili i monitoruesit .....	18
5. Menu: Shto raport .....	20
6. Menu: Raportet e mia .....	28

*Ky manual është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit European dhe Këshillit të Europës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.*

---

## Tabela e figurave

---

Figura 1. Identifikohu në sistem.

Figura 2. Kredencialet janë gabim.

Figura 3. Harrove fjalëkalimin?

Figura 4. Vendos *e-mail*-in për të rikuperuar fjalëkalimin.

Figura 5. Dërgo kodin.

Figura 6. Konfirmo.

Figura 7. Vendos fjalëkalim të ri.

Figura 8. Nuk morët një kod? Ridërgo kodin.

Figura 9. Statistika të raporteve të monitorimit.

Figura 10. Menu Kryesore Vertikale

Figura 11. Menu Kryesore Horizontale

Figura 12. Profili i monitoruesit.

Figura 13. Shto raport.

Figura 15. Zgjidh subjekt zgjedhor.

Figura 16. Shto zyrë zgjedhore.

Figura 17. Të dhënat e zyrës zgjedhore.

Figura 18. Çfarë konstaton?

Figura 19. Çfarë konstaton për kategorinë "Zyrë zgjedhore"?

Figura 20. Ngarko figura – Çfarë konstaton për kategorinë "Zyrë zgjedhore".

Figura 21. Çfarë konstaton për kategorinë "Materiale propagandistike"?

Figura 21. Ngarko figura çfarë konstaton për kategorinë "Materiale propagandistike".

Figura 22. Çfarë konstaton për kategorinë "Aktiviteti/Ngjarja e fushatës"?

Figura 23. Ngarko figura çfarë konstaton për kategorinë "Aktiviteti/Ngjarja e fushatës".

Figura 24. Çfarë konstaton për kategorinë "Abuzimi i burimeve shtetërore"?

### Shtojca nr. 3

Figura 25. Ngarko figura çfarë konstaton për kategorinë “Abuzimi i burimeve shtetërore”.

Figura 26. Ruaj raportin.

Figura 27. Konfirmo procesin.

Figura 28. Lista me raportet.

## 1. Hyrje

---

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve.

Drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore, të medias në raport me zgjedhjet.

Zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat në lidhje me procesin zgjedhor.

Ligji nr. 101/2020 krijoi një arkitekturë të re të administrimit zgjedhor me formimin e tri organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që janë:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
2. Komisioni Rregullator;
3. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Veprimtaria e KQZ-së, organeve drejtuese dhe administratës udhëhiqet sipas rastit nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe nga ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka planifikuar digjitalizimin e procesit të monitorimit të raporteve financiare të partive politike bazuar në kuadrin ligjor në fuqi: Kodi Zgjedhor, ligji për partitë politike dhe aktet nënligjore të KQZ-së për financimin e subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore. Është evidentuar nevoja për të zhvilluar një platformë online për të lehtësuar procesin e monitorimit të financave të partive politike dhe fushatave zgjedhore.

Ky portal do të përmbajë disa faza të rëndësishme të financimit të partive politike për KQZ-në, që nga momenti i vetëdeklarimit të pasqyrave financiare nga partitë politike si për vit jozgjedhor, ashtu edhe për fushata zgjedhore, monitorimi i tyre gjatë procesit zgjedhor, përfshirja e KQZ-së përgjatë procesit të auditimit (komunikimet auditues - financier partie) dhe në fund vendimmarrja.

Portali i deklarimit online do të lehtësojë procesin e plotësimit të raporteve financiare, raporteve të monitoruesve gjatë fushatës zgjedhore dhe raporteve të auditimit duke i mundësuar në mënyrë elektronike, të shpejtë, të sigurt dhe duke minimizuar gabimet e mundshme nëpërmjet zhvillimit të dokumenteve të sigurta elektronike.

### 1.1 Qëllimi i manualit

Manuali ka për qëllim shpjegimin e funksionaliteteve kryesore të ofruara nga ky sistem duke u ardhur në ndihmë monitoruesve, të cilët do të jenë një nga përdoruesit fundorë të sistemit.

Të gjitha funksionalitet që ofron portali do të përshkruhen dhe do të ilustrohen me imazhe për të dhënë një shpjegim sa më të mirë të gjithë proceseve të sistemit .

## 2. Ndërfaqja e identifikimit të përdoruesit në sistem

---

Përdoruesi do të aksesojë ndërfaqen e sistemit nëpërmjet linkut të autorizuar nga KQZ-ja.

Përdoruesi plotëson fushat **E-mail** dhe **Fjalëkalimi** dhe më pas klikon **"Identifikohu"** për t'u identifikuar në sistem.

Përdoruesit do t'i kërkohet të ndryshojë fjalëkalimin me një përdorim që i jepet nga KQZ-ja.




Figura 1. Identifikohu në sistem.

Nëse përdoruesi vendos kredenciale të pasakta të **E-mailit** dhe **Fjalëkalimit**, do t'i shfaqet një mesazh që e lajmëron për kredenciale të gabuara.




Figura 2. Kredencialet janë gabim.

Nëse përdoruesi ka harruar fjalëkalimin dhe dëshiron ta ndryshojë atë, ai mund të klikojë mbi butonin **"Harruat Fjalëkalimin?"**.






Figura 3. Harrove fjalëkalimin?

Duke klikuar mbi butonin “**Harruat Fjalëkalimin?**”, përdoruesit do t’i kërkohet që të vendosë e-mail-in e regjistrimit nga KQZ-ja, ku do t’i dërgohet një kod për ndryshimin e fjalëkalimit.




Figura 4. Vendos *e-mail*-in për të rikuperuar fjalëkalimin.

Përdoruesi plotëson fushën me e-mail-in e tij dhe klikon mbi butonin **"Dërgo kodin"**.




Figura 5. Dërgo Kodin.

Përdoruesi hyn në adresën e e-mail-it, merr kodin e verifikimit që i është dërguar, e vendos atë tek ndërfaja ku i është kërkuar dhe klikon butonin **"Konfirmo"**.





Figura 6. Konfirmo.

Përdoruesi vendos dhe konfirmon atë. Pasi janë plotësuar fushat e fjalëkalimit, ai klikon mbi butonin **"Ruaj"** për të ndryshuar fjalëkalimin e tij.



### Figura 7. Vendos fjalëkalim të ri.

Fjalëkalimi që vendos përdoruesi duhet të përmbajë 8 karaktere ose më shumë.

Nëse përdoruesi vendos një fjalëkalim që nuk e përmbush standardin, fjalëkalimi shfaqet me një vijë të kuqe dhe nuk mund të ruhet.




Figura 8. Standardi për fjalëkalimin e ri.

Shtojca nr. 3

Nëse kodi nuk është dërguar ose ka skaduar, përdoruesi duhet të klikojë tek opsioni **“Nuk morët një kod? Ridërgo kodin”**.




Figura 9. Nuk morët një kod? Ridërgo kodin.

Shtojca nr. 3

Përdoruesi ka vendosur kredenciale të sakta dhe është identifikuar në sistem. Pas kësaj ai do të shikojë ndërfaqen me të drejtat e tij përkatëse.

### 3. Menu Kryesore

---

Në menunë kryesore, përdoruesi do të shohë paraqitjen e raporteve të monitorimit në mënyrë grafike. Në raport do të pasqyrohet statusi i raportit: "Draft", "Në pritje", "Miratuar", "Refuzuar".




Figura 10. Statistika të raporteve të monitorimit.

Përdoruesi do të shohë Menunë Kryesore Vertikale, që do të ketë të përfshirë: "Informacion i Përmbledhur", "Shto raport" dhe "Raportet e mia".





Figura 11. Menu Kryesore Vertikale

Përdoruesi do të shohë Menunë Kryesore Horizontale në të djathtë, që do të ketë ikonën e profilit të përdoruesit, ikonën e njoftimeve dhe ikonën e daljes nga sistemi.



Figura 12. Menu Kryesore Horizontale

Shtojca nr. 3

Në fund të platformës, përdoruesi do të mund të shohë akseset e lehtësuara, legjislacionin, rrjetet sociale dhe bordin e transparencës.



Figura 13. Footer i platformës.

## 4. Menu: Profili i Monitoruesit

Në menunë kryesore monitoruesi do të shohë ikonën e profilit të vet. Pasi klikon tek ikona, dritarja që do të shfaqet është si vijon:

Figura 14. Profili i monitoruesit.

Shtojca nr. 3

Përdoruesi do të ketë mundësinë të bëjë përditësime të të dhënave. Pasi bën këto ndryshime, ai klikon tek butoni **"Ruaj"**. Të dhënat do të jenë ruajtur me sukses.

E vetmja e dhënë që nuk mund të ndryshohet është adresa e e-mailit. Në rastet kur ndryshimi i adresës së e-mailit është i domosdoshëm, monitoruesi duhet të bëjë kërkesë pranë KQZ-së për ndryshimin e saj.

## 5. Menu: Shto Raport

Përdoruesi shkon tek menuja “Shto raport” për të krijuar një raport të ri monitorimi.

The screenshot shows the 'Shto Raport' form with the following fields and sections:

- Hapësira e Monitoruesit:**
  - Informacion i Përmbledhur
  - Shto Raport**
  - Raportet e mia
- Raporti mbi monitorimin:**
  - Data e monitorimit:** Zgjidhni Datën
  - Vendi i monitorimit:** Zgjidhni Qarkun, Zgjidhni Bashkinë, Zgjidhni Njësinë Vendore
  - Subjekti i Monitoruar:** Subjekti Zgjedhor
  - Zyra zgjedhore të identifikuar:** Zgjidhni Zyrë Zgjedhore
  - Përshkruaj aktivitetin e kryer:** Përshkruaj...
  - Çfare Konstaton për:** Zyrat Zgjedhore
- Ngarko Foto** button

Figura 15. Shto raport.

Përdoruesi do të zgjedhë datën **kur** ka ndodhur monitorimi, vendin **ku** ka ndodhur, **cili** është subjekti që po monitorohet (subjekt zgjedhor, kandidat apo institucion publik), të ngarkojë foto të vendit/ngjarjes për të cilin/ën po raportohet.

Në varësi se **cili** është subjekti që po monitorohet apo ka kryer shkelje, monitoruesit do t'i shfaqen për t'u plotësuar:




Figura 16. Subjekti i monitoruar

Në rast se përdoruesi do të zgjedhë që shkelja është kryer nga subjekti zgjedhor, ai duhet të zgjedhë subjektin.




Figura 17. Zgjidh subjekt zgjedhor.

Përdoruesi, sipas rastit, do të zgjedhë gjithashtu zyrën zgjedhore për të cilën do të raportojë apo ku ka ndodhur shkelja. Në rast se zyra zgjedhore nuk ndodhet në listë, ai duhet ta shtojë atë. Për të shtuar një zyrë zgjedhore, përdoruesi duhet të klikojë tek butoni **"Shto zyrë zgjedhore."**

The screenshot shows a web form titled "Subjekti i Monitoruar" (Monitored Subject). It contains several input fields: "Subjekt Zgjedhor" (Elected Subject), "Zgjidhni Subjektin Zgjedhor" (Select the Elected Subject), and "Zgjidhni Zyre Zgjedhore" (Select the Representative Office). Below the last field, there is a message "Nuk u gjet asnje zyre zgjedhore" (No representative office found) and a button labeled "+ Shto Zyre Zgjedhore" (Add Representative Office), which is highlighted with a red rectangle. Below this section, there is another section titled "Cfare Konstaton për" (What do you declare) with a dropdown menu currently set to "Zyrat Zgjedhore" (Representative Offices).

Figura 18. Shto zyrë zgjedhore.

Përdoruesi duhet të plotësojë emrin/përshkrimin e zyrës zgjedhore, adresën dhe sipërfaqen e saj dhe më pas të klikojë butonin **"Ruaj."** Të dhënat e tjera si partia politike, qarku dhe bashkia plotësohen në mënyrë automatike nga ato çfarë monitoruesi ka deklaruar në fillim të raportit të monitorimit.

Shto Zyrë Zgjedhore

Emri/Përshkrimi i Zyrës Zgjedhore

Partia Test

Kukës

Bashkia Tropojë

Adresa

Sipërfaqja

Ngarko Foto

Ruaj

Figura 19. Të dhënat e zyrës zgjedhore.

Përdoruesi më pas do të zgjedhë **“Çfarë konstaton”**. Janë katër grupet e mëdha të konstatimit të shkeljeve:

- 1- Zyra zgjedhore
- 2- Materiale propagandistike të fushatës zgjedhore
- 3- Aktiviteti/Ngjarja e fushatës
- 4- Abuzimi i burimeve shtetërore

► Çfarë Konstaton

> Zyrat Zgjedhore

> Materiale Propagandiste te fushates Zgjedhore

> Aktiviteti Ngjarja e fushates

> Abuzimi i burimeve shteterore

Figura 20. Çfarë konstaton?

Në rast se zgjedh kategorinë **“Zyrat zgjedhore”**, përdoruesit do t’i shfaqen opsionet si më poshtë:

### Shtojca nr. 3

► Cfare Konstaton

▼ Zyrat Zgjedhore

- Më afër se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve?
- Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyra elektorale?
- Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike

Figura 21. Çfarë konstaton për kategorinë “Zyrë zgjedhore”?

Në varësi të shkeljes, përdoruesi duhet të zgjedhë një nga opsionet për kategori.

Për secilin nga opsionet, përdoruesi mund të shtojë informacion përshkrues dhe të ngarkojë foto.

Zgjidhni Zyre Zgjedhore

► Cfare Konstaton

▼ Zyrat Zgjedhore

- Më afër se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve?

Shto Përkshim...

Ngarko Foto

- Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyra elektorale?
- Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike

> Materiale Propagandiste te fushates Zgjedhore

> Aktiviteti Ngjarja e fushates

> Abuzimi i burimeve shteterore

Ruajt si Draft

Ngarko ne Sistem

Figura 22. Çfarë konstaton për kategorinë “Zyrë zgjedhore”

Nëse zgjedh kategorinë “**Materiale propagandistike të fushatës zgjedhore**”, përdoruesi do të shohë këto opsione.

► Cfare Konstaton

> Zyrat Zgjedhore

▼ Materiale Propagandiste te fushates Zgjedhore

- Vendosja e materialeve propagandistike jashtë vendit të afishimit të caktuar me vendim të Bashkisë
- Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike
- Vendosja e materialeve propagandistike në fasadat e godinave të banimit, institucione publike ose ambiente rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimi
- Vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik
- Te tjera

Figura 23. Çfarë konstaton për kategorinë “Materiale propagandistike” ?

Për secilin nga opsionet, përdoruesi mund të shtojë informacion përshkrues (tekst i lirë) dhe të ngarkojë foto.



### Shtojca nr. 3

▼ Materiale Propagandiste te fushates Zgjedhore

Vendosija e materialeve propagandistike jashtë vendit të afishimit të caktuar me vendim të Bashkisë

Shto Përshkrim...

Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në materialet vizive të fushatës propagandistike

Ngarko Foto

Figura 24. Çfarë konstaton për kategorinë “Materiale propagandistike” – Shto tekst dhe imazhe.

Nëse zgjedh kategorinë “Aktiviteti/Ngjarja e fushatës” do të shohë këto opsione.

▼ Aktiviteti Ngjarja e fushates

Fushatë zgjedhore në një institucion publik

Subjektet zgjedhore/kandidatët i ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune ose favore të tjera, votuesve ose personave të tjerë që kanë lidhje me të, me qëllim marrjen e nënshkrimit për emërimin e një kandidati për zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votim, ose në këmbim të angazhimit në aktivitete jo ligjore për të mbështetur një kandidat ose një parti politike

Subjekti zgjedhor/Kandidati që organizon ose mbulon shpenzimet për koncert, ngjarje kulturore dhe zbavitëse ose aktivitete bamirësie

Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron artikuj ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5 (pesë) qind Lekë për sende ose materiale të fushatës zgjedhore

Te Tjera

Figura 25. Çfarë konstaton për kategorinë “Aktiviteti/Ngjarja e fushatës”?

Për secilin nga opsionet, përdoruesi mund të shtojë informacion përshkrues dhe të ngarkojë foto.

► Cfare Konstaton

> Zyrat Zgjedhore

> Materiale Propagandiste te fushates Zgjedhore

▼ Aktiviteti Ngjarja e fushates

Fushatë zgjedhore në një institucion publik

Shto Përshkrim...

Ngarko Foto

Figura 26. Ngarko imazhe çfarë konstaton për kategorinë “Aktiviteti/Ngjarja e fushatës”.

Nëse zgjedh kategorinë “Abuzimi i burimeve shtetërore”, përdoruesi do të shohë këto opsione.

### Shtojca nr. 3

Abuzimi i burimeve shtetërore

- Angazhimi i detyruar i nëpunësve publik/njësive administrative në aktivitetet e fushatës gjatë orarit të punës
- Punësimi, pushimi nga puna, kontratat e përkohshme ose afat-shkurtër të punësimit gjatë fushatës zgjedhore
- Nisja e propozimeve, aprovimeve ose nxjerrjen e akteve ligjore, si dhe akteve nënligjore nga të cilat përfitojnë kategori të caktuara të njerëzve
- Përdorimi i mjediseve të njësive administrative /shtetërore pa u privuar, që dhe kandidatëve të tjerë u garantohet përdorimi i këtyre mjediseve në të njëjtat kushte
- Prezantimi i projekteve shoqërore/publike fillimi i të cilëve përkon me periudhën e fushatës zgjedhore dhe që nuk janë lajmëruar paraprakisht
- Përdorimi i automjeteve (të bashkive /shtetërore) /mjediseve publike për qëllimet e fushatës
- Te Tjera

Figura 27. Çfarë konstaton për kategorinë “Abuzimi i burimeve shtetërore”?

Për secilin nga opsionet, përdoruesi mund të shtojë informacion dhe të ngarkojë foto.

Abuzimi i burimeve shtetërore

Angazhimi i detyruar i nëpunësve publik/njësive administrative në aktivitetet e fushatës gjatë orarit të punës

Shto Peshkrim...

Ngarko Foto

Punësimi, pushimi nga puna, kontratat e përkohshme ose afat-shkurtër të punësimit gjatë fushatës zgjedhore

Nisja e propozimeve, aprovimeve ose nxjerrjen e akteve ligjore, si dhe akteve nënligjore nga të cilat përfitojnë kategori të caktuara të njerëzve

Përdorimi i mjediseve të njësive administrative /shtetërore pa u privuar, që dhe kandidatëve të tjerë u garantohet përdorimi i këtyre mjediseve në të njëjtat kushte

Prezantimi i projekteve shoqërore/publike fillimi i të cilëve përkon me periudhën e fushatës zgjedhore dhe që nuk janë lajmëruar paraprakisht

Përdorimi i automjeteve (të bashkive /shtetërore) /mjediseve publike për qëllimet e fushatës

Te Tjera

Ruaj si Draft Ngarko ne Sistem

Figura 28. Ngarko figura çfarë konstaton për kategorinë “Abuzimi i burimeve shtetërore”.

Përdoruesi mund ta ruajë si draft raportin duke pasur kështu mundësinë që ta përditësojë sërish ose ta ngarkojë atë në sistem për aprovim.

Ruaj si Draft Ngarko ne Sistem

Figura 29. Ruaj raportin.

Nëse klikon **“Ngarko në sistem”**, përdoruesit do t’i shfaqet një mesazh ku pyetet nëse është i sigurt që do të përfundojë veprimin apo jo.



Figura 30. Konfirmo procesin.

Duke klikuar **"Po"**, raporti ruhet dhe shfaqet një mesazh që është ruajtur me sukses, përndryshe monitoruesi mund të vazhdojë me përditësimin/plotësimin e raportit.

Nëse klikon **"Ruaj si draft"**, përdoruesi do të mund ta ruajë raportin si draft. Raportet e ruajtura do të shfaqen te paneli i kontrollit me statusin **"Në Pritje"**.


Monitoruesi ka detyrimin që të dorëzojë të paktën **një raport përgjatë periudhës 10-ditore**. Për t'u lehtësuar punën monitoruesve, sistemi në mënyrë automatike bën bashkimin e të gjitha raporteve të ngarkuara gjatë 10 ditëve. Gjithashtu monitoruesit do të njoftohen me njoftim nga sistemi dhe me e-mail një ditë para përfundimit të afatit 10-ditor, për të ngarkuar raportet në sistem.

Gjithashtu, në ditën e zgjedhjeve sistemi do të dërgojë njoftim tek të gjithë monitoruesit se kanë detyrimin që brenda 7 ditëve të dorëzojnë **raportin përfundimtar**. Monitoruesi mund të plotësojë një raport si gjithë të tjerët dhe sistemi në mënyrë automatike do të bëjë bashkimin e të gjitha raporteve të ngarkuara nga momenti i fillimit të aktivitetit në sistem.

## 6. Menu: Raportet e mia

Përdoruesi do të shohë listën e raporteve që ka krijuar sipas datës për të cilën është raportuar, datës kur është krijuar raporti, statusi në të cilin është, lloji i raportit dhe veprimi që mund të kryhet me këtë raport në varësi të statusit që ai ka.

Monitoruesi mund t'i përditësojë të gjitha raportet që i ka me statusin *draft* e më pas t'i ngarkojë ato në sistem.



Nr	Data e monitorimit	Data e raportimit	Statusi	Veprimi
1	26 Prill, 2023, 3:13 PM	26 Prill, 2023, 4:06 PM	Miratuar	↓
2	25 Prill, 2023, 10:36 AM	28 Prill, 2023, 11:33 AM	Miratuar	↓
3	4 Prill, 2023, 1:37 PM	26 Prill, 2023, 4:06 PM	Në pritje	🕒
4	7 Prill, 2023, 5:36 PM	25 Prill, 2023, 5:58 PM	Miratuar	↓
5	4 Prill, 2023, 2:27 PM	29 Prill, 2023, 6:06 PM	Refuzuar	❌
6	5 Prill, 2023, 4:49 PM	26 Prill, 2023, 2:42 PM	Në pritje	🕒

Figura 31. Lista me raportet

Pasi monitoruesi ka ngarkuar raportin në sistem, statusi i tij do të jetë "Në pritje".

Në rastin kur KQZ-ja refuzon raportin e monitorimit, monitoruesi do të njoftohet me e-mail dhe nga sistemi për ndryshimin e statusit të raportit.




Figura 32. Njoftimet e sistemit.

Duke klikuar raportin e refuzuar, shfaqet arsyeja e refuzimit të këtij raporti. Monitoruesi ka mundësinë që të bëjë ndryshimet e nevojshme në raport sipas komenteve të KQZ-së dhe ta ridërgojë atë për aprovim.




Figura 33. Refuzimi i raportit

Pas aprovimit të raporteve nga KQZ-ja, monitoruesi do të ketë mundësinë që ta shkarkojë raportin, nëse do të jetë e nevojshme.

Nga ky moment, raportet do të bëhen gjithashtu publike dhe të aksesueshme tek URL <https://fpp.kqz.gov.al/kreu>

Platforma Elektronike e Raportimit Financiar

Këtu mund të konsultoheni me raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore, raportet financiare të partive politike si dhe raportet e auditimit. Përmes filtrave ju mund të përzgjidhni llojin e raportit dhe informacione specifike

Raporti i monitorimit × Zgjidh Raportin e Monitorimit Zgjidh Vitin Zgjidh Partinë Politike/Subjektin Zgjedhor

Apliko Filtrat Pastro Filtrat

Nr	Emërtimi	Viti	Shiko	Shkarko
1	Raport monitorimi i monitoruesit N.P	2023	👁	📄
2	Raport monitorimi i monitoruesit N.P	2023	👁	📄
3	Raport monitorimi i monitoruesit N.P	2023	👁	📄
4	Raport monitorimi i monitoruesit L.B	2023	👁	📄
5	Raport monitorimi i monitoruesit E.X	2023	👁	📄
6	Raport monitorimi i monitoruesit M.S	2023	👁	📄
7	Raport monitorimi i monitoruesit M.S	2023	👁	📄
8	Raport monitorimi i monitoruesit M.S	2023	👁	📄
9	Raport monitorimi i monitoruesit M.S	2023	👁	📄
10	Raport monitorimi i monitoruesit M.S	2023	👁	📄

Sfaqur 1 deri 10 nga 1048 raporte << < 1 2 3 4 5 > >>

Akses i Lehtësuar

Legjislacioni

Kushtetuta

Kodi Zgjedhor

Ugji për partitë politike

Ugji dekriminalizimit

Transparenca

Koordinatori

Programi

Modelet

Informacione

Rrjetet Sociale

© 2023 | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – Të gjithë të drejtat e rezervuara | Politikat e Privatësisë

Figura 34. Publikimi i raporteve

# Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

2023

Co-funded  
by the European Union



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Co-funded and implemented  
by the Council of Europe